

NJOFTIME FITUESI PËR PROCEDURA TË KUFIZUARA

BASHKIA LEZHË

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË
MARRËVESHJEN KUADËR
PËR:

BASHKIMIN E OPERATOREVE EKONOMIK “2Z KONSTRUKSION” SH.P.K & “RAFIN
COMPANY” SH.P.K, PERFAQESUAR NGA OE “2Z KONSTRUKSION” SH.P.K, ME ADRESE
FSHATI SUKE I SIPERM, NR 2, RRUGA STRUM - SUKE, KM 3, LAGJJA ZOGA, STRUM,
ROSKOVEC, FIER,

BASHKIMIN E OPERATOREVE EKONOMIKE “JUNIK” SH.P.K & “PEPA GROUP” SH.P.K,
PERFAQESUAR NGA OE “JUNIK” SH.P.K, ME ADRESE LAGJJA SMT, NDERTESE 2-
KATESHE, KATI 2, PRANE DREJTORISE SHERBIMIT PYJOR, LEZHE.

* * *

Procedura e prokurimit: Tender i Kufizuar/ Pune (në kuadër të procesit të rindërtimit).

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-51458-11-30-2022.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Riforcimi i njesive te banimit ne ndertesat (pallat), ne kuader te procesit te rindertimit, ne territorin e Bashkise Lezhe” Loti II.

Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër: 12 Muaj nga data e nënshkrimit te marrëveshjes Kuader.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: X oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë:

- 1- Bashkimi i Operatoreve Ekonomike “2Z KONSTRUKSION” SH.P.K, me Nuis J63229466K & “RAFIN COMPANY” SH.P.K, me Nuis L52125110A,
- 2- Operatori Ekonomik “A. N. K” SH.P.K, me Nuis J92408001N,
- 3- Operatori Ekonomik “AURORA KONSTRUKSION” SH.P.K, me Nuis K02017003I,
- 4- Operatori Ekonomik “BAMI” SH.P.K, me Nuis J94416206R,
- 5- Bashkimi i Operatoreve Ekonomike “JUNIK” SH.P.K, me Nuis J68007522L & “PEPA GROUP” SH.P.K, me Nuis L42215009L,
- 6- Operatori Ekonomik “NDREGJONI” SH.P.K, me Nuis K31329048I,
- 7- Operatori Ekonomik “S I R E T A 2F” SH.P.K, me Nuis K51501008J,
- 8- Bashkimi i Operatoreve Ekonomike “XHAŠT SHPK”, me Nuis K12512837I & “DENIS-05” SH.P.K, me Nuis K51518029B.

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

- 1- Operatori Ekonomik “A. N. K” SH.P.K, me Nuis J92408001N,

- 2- Operatori Ekonomik “AURORA KONSTRUKSION” SH.P.K, me Nuis K02017003I,
- 3- Operatori Ekonomik “BAMI” SH.P.K, me Nuis J94416206R,
- 4- Operatori Ekonomik “NDREGJONI” SH.P.K, me Nuis K31329048I,
- 5- Operatori Ekonomik “S I R E T A 2F” SH.P.K, me Nuis K51501008J,
- 6- Bashkimi i Operatoreve Ekonomike “XHAŠT SHPK”, me Nuis K12512837I & “DENIS-05” SH.P.K, me Nuis K51518029B.

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- I- Operatori Ekonomik “A. N. K” SH.P.K, me Nuis J92408001N,

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se OE:

Nuk permbush kriterin 2.3.5, te DST-se, ku parashikohet se: *“Krahas stafit teknik Operoret Ekonomike duhet te kene te punesuar staf mbeshtetes si me poshte:*

- Bojagji	2 (dy)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Kualifikimi
- Elektracist	2 (dy)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Kualifikimi
- Hidraulik	2 (dy)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Kualifikimi
- Hekurkthyes	2 (dy)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Kualifikimi
- Karpertier	2 (dy)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Kualifikimi
- Murator	2 (dy)	Çertifikate trajnimi/Deshmi Kualifikimi
- Shofer	2 (dy)	Leje Drejtimi

Operatori ekonomik duhet te paraqese per stafin e mesiperm: Kontratat individuale te punës, Çertifikate trajnimi/ Dëshmite Kualifikimi/leje drejtimi, sipas shenimeve per cdo kategori te mesiperme si dhe stafi i mesiperm te figuroje ne listepagesat e shoqerise per periudhen Gusht 2022-Tetor 2022”.

KVO veren se per permbushjen e ketij kriteri operoret ekonomike duhet te disponojne te punesuar stafin mbeshtetes te sipercituar, si dhe per te provuar kete duhet te paraqesin Kontratat individuale te punës, Çertifikate trajnimi/ Dëshmite Kualifikimi/leje drejtimi sipas shenimeve per cdo kategori te mesiperme si dhe stafi i mesiperm te figuroje ne listepagesat e shoqerise per periudhen Gusht 2022-Tetor 2022”.

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE, rezulton se ky OE ka paraqitur per stafin mbeshtetes *“Deshmi sigurimi teknik”* te leshuar nga Trupa certifikuese “TCPE”.

KVO thekson se Trupa “TCPE” SH.P.K, është organizëm certifikimi personeli që certifikon personelin elektrik për përdorimin e paisjeve elektrike dhe nuk certifikon apo organizon kurse profesionale per Bojagji, Hidraulik, Hekurkthyes, Karpertier apo Murator.

KVO sqaron se edhe ne deshmine e sigurimit teknik te paraqitur nga ky OE per Bojagji, Hidraulik, Hekurkthyes, Karpertier dhe Murator eshte theksuar qarte shenimi *“Deshmi sigurimi teknik “Per punonjesit qe punojne me impiantet, pajisjet dhe instalimet elektrike, apo ne afersi te tyre”.*

Per sa me lart ky OE nuk permbush disponimin e stafit mbeshtetes Bojagji, Hidraulik, Hekurkthyes, Karpertier dhe Murator te kerkuar ne DST dhe ky kriter konsiderohet i papermbushur.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të

kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e OE “A. N. K” SH.P.K, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si përfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “A. N. K” SH.P.K, me Nuis J92408001N, *skualifikohet*.

II- Operatori Ekonomik “AURORA KONSTRUKSION” SH.P.K, me Nuis K02017003I,

Nga verifikimi i dokumentacionit në SPE rezulton se BOE:

Se pari, nuk ka paraqitur asnjë nga shtojcat e parashikuara në DST-ne e miratuar me VKM nr. 225, date 12.04.2021 *"Per nje ndryshim ne vendimin nr. 199, date 04.03.2020, te Keshillit te Ministrave, "Per miratimin e Dokumenteve Standarde te procedures se prokurimit, te kriterëve te vleresimit te ofertes fituese, kushteve te marreveshjes kuader dhe te kontrates per procesin e rindertimit", te ndryshuar*.

KVO theson se për plotësimin e këtij kriteri të vendosur nga ligjvënosi, OE-te duhet të paraqesin shtojcat dhe deklaratat sipas kesaj DST-je.

Për më tepër keto shtojca janë vendosur nga autoritetet përkatëse në DST, të kriteret e vecanta (shtojcat), të cilat nuk mund të ndryshohen nga autoritetet kontraktore. Mospërmbushja e këtyre kriterëve përben shkak për skualifikimin e ofertuesve.

Nga verifikimi i dokumentacionit në SPE, rezulton se ky OE nuk ka paraqitur në SPE shtojcat sipas DST-se për rindertimin, duke e bërë të pa përmbushur këto kriter.

Se dyti, nuk ploteson kriterin 2.3.12/2 te kriterëve te vecanta te kualifikimit ku parashikohet se “2.3.12 Operatori ekonomik ne rast se nuk eshte prodhues duhet te paraqese kontrate furnizimit per materialet si me poshte:

2.3.12/2 Per Pllakat:

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave veren se per permbushjen e ketij kriteri operatorët ekonomike duhet te paraqesin per secilin nga materialet e kerkuar: Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Nga verifikimi ne SPE rezulton se per “Pllakat”, BOE ka paraqitur kontrate furnizimi me operator (furnizues) i cili nuk eshte prodhues.

KVO duke pasur ne konsiderate se te gjithë prodhuesit e kane detyrim ligjor pajisjen me leje mjedisore nga QKL, beri nje kerkim ne faqen zyrtare qkb.gov.al, ku rezultoi se furnizuesi per “Pllakat” nuk disponon QKL si prodhues.

Po ashtu, KVO veren se OE nuk ka paraqitur per furnizuesin autorizimin/ aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis tij dhe prodhuesit.

KVO mban ne konsiderate se edhe Komisioni i Prokurimit Publik ne vendimin nr. 825/2021 gjykon se per te permbushur qellimin e vendosjes se kriterit duhet te parashikohen forma apo dokumentacione alternative provuese te cilat vertetojne lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit te autorizuar nga prodhuesi.

Sa me siper duke qene se furnizuesi per “Pllakat” nuk disponon QKL si prodhues, si dhe duke qene se nuk ka paraqitur per furnizuesin autorizimin/ aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis tij dhe prodhuesit ky kriter konsiderohet i papermbushur.

Se treti, nuk ploteson kriterin 2.3.12/3 dhe 2.3.12/4 te kriterëve te vecanta te kualifikimit ku parashikohet se “2.3.12 Operatori ekonomik ne rast se nuk eshte prodhues duhet te paraqese kontrate furnizimit per materialet si me poshte:

2.3.12/3 Per materialet e termoizolimit dhe suvase:

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

2.3.12/4 Per materialet hidroizoluese:

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave veren se per permbushjen e ketij kriteri operatorët ekonomike duhet te paraqesin per secilin nga materialet e kerkuar: Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin

ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Nga verifikimi në SPE rezulton se për *materialet e termoizolimit dhe suvase, si dhe për materialet hidroizoluese*, BOE ka paraqitur kontrate furnizimi me operator (furnizues) i cili nuk është prodhues.

Po ashtu nga verifikimi në SPE, vërehet se bashkëngjitur kontrates së furnizimit, BOE ka paraqitur një dokument në gjuhën angleze, të paperkthyer në gjuhën shqipe, të cilin e ka paraqitur si autorizim.

KVO vëren se në pikën 2, të nenit 24, të VKM-së 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet se:

2. Në rastin e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, dokumentet e tenderit duhet të hartohen në gjuhët shqip dhe anglisht. Operatorët ekonomikë mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht. Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe. Në këto procedura, në raste specifike, nëse autoriteti/enti kontraktor e gjykon të nevojshme, mund të hartojë dokumentet e tenderit në gjuhët shqip dhe anglisht dhe njofton operatorët ekonomikë se mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik në vendimin nr. 825/2021, mban të njëjtin qëndrim në të cilin theksohet se: *“II.4.4. Komisioni i Prokurimit Publik, referuar përcaktimeve ligjore mbi përdorimi e gjuhës shqipe në dokumentet e tenderit, për të qenë sa më të kuptueshme për palët dhe për të krahasuar përputhshmërinë e parametrave dhe të dhënave të mallit që prokurohet, është e nevojshme që për artikujt, objekt-prokurimi, të dhënat e katalogut të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe, gjuhë e përdorur në dokumentet e procedurës së prokurimit. Në këtë kuptim KPP gjykon, se autoriteti kontraktor ka hartuar kriterin në përputhje me dispozitat ligjore dhe kriteri nuk le vend për konfuzion”.*

Sa me sipër duke qenë se furnizuesi i paraqitur nga OE për materialet e mesiperme nuk është prodhues, si dhe autorizimi i prodhuesit është i paperkthyer në gjuhën shqipe ky kriter konsiderohet i papermbushur.

Se katërti, nuk plotëson kriterin 2.3.12/5 të kriterëve të vecanta të kualifikimit ku parashikohet se *“2.3.12 Operatori ekonomik në rast se nuk është prodhues duhet të paraqesë kontrate furnizimit për materialet si më poshtë:*

2.3.12/5 Për materialet elektrike dhe hidraulike:

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar”.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vëren se për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomike duhet të paraqesin për secilin nga materialet e kërkuar: Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Nga verifikimi ne SPE rezulton se per *materialet elektrike dhe hidraulike*, BOE ka paraqitur kontrate furnizimi me operator (furnizues) i cili nuk eshte prodhues.

Po ashtu nga verifikimi ne SPE, verehet se bashkengjitur kontrates se furnizimit, BOE ka paraqitur nje dokument ne gjuhen angleze, te paperkthyer ne gjuhen shqipe , te cilin e ka paraqitur si autorizim.

KVO veren se ne piken 2, te nenit 24, te VKM-se 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet se:

2. Në rastin e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, dokumentet e tenderit duhet të hartohen në gjuhët shqip dhe anglisht. Operatorët ekonomikë mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht. Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe. Në këto procedura, në raste specifike, nëse autoriteti/enti kontraktor e gjykon të nevojshme, mund të hartojë dokumentet e tenderit në gjuhët shqip dhe anglisht dhe njofton operatorët ekonomikë se mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik ne vendimin nr. 825/2021, mban te njejtin qendrim ne te cilin theksohet se: *“II.4.4. Komisioni i Prokurimit Publik, referuar përcaktimeve ligjore mbi përdorimi e gjuhës shqipe në dokumentet e tenderit, për të qenë sa më të kuptueshme për palët dhe për të krahasuar përputhshmërinë e parametrave dhe të dhënave të mallit që prokurohet, është e nevojshme që për artikujt, objekt-prokurimi, të dhënat e katalogut të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe, gjuhë e përdorur në dokumentet e procedurës së prokurimit. Në këtë kuptim KPP gjykon, se autoriteti kontraktor ka hartuar kriterin në përputhje me dispozitat ligjore dhe kriteri nuk le vend për konfuzion”.*

Sa me siper duke qene se furnizuesi i paraqitur nga OE per materialet e mesiperme nuk eshte prodhues, si dhe autorizimi i prodhuesit eshte i paperkthyer ne gjuhen shqipe ky kriter konsiderohet i papermbushur.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe ne në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson

një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e OE “AURORA KONSTRUKSION” SH.P.K, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si përfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “AURORA KONSTRUKSION” SH.P.K, me Nuis K02017003I, *skualifikohet*.

III- Operatori Ekonomik “BAMI” SH.P.K, me Nuis J94416206R,

Nga verifikimi i dokumentacionit në SPE rezulton se OE:

Se pari, nuk ploteson kriterin 2.3.4, të kriterëve të vecanta të kualifikimit ku parashikohet se: *Operatorët Ekonomike duhet të kenë pjesë të stafit teknik të shoqërisë dhe të figurojnë në Licensën e kompanisë si më poshtë:*

<i>Inxhinier Ndërtimi</i>	<i>1 (nje)</i>	<i>Diplome Universitare</i>
<i>Inxhinier Elektrik</i>	<i>1 (nje)</i>	<i>Diplome Universitare</i>
<i>Inxhinier Hidroteknik</i>	<i>1 (nje)</i>	<i>Diplome Universitare</i>
<i>Inxhinier Mjedisi</i>	<i>1 (nje)</i>	<i>Diplome Universitare</i>
<i>Inxhinier Topograf</i>	<i>1 (nje)</i>	<i>Diplome Universitare</i>

-Për stafin e mesipër Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë: Kontratë pune e vlefshme, Diploma Universitare si dhe të figurojnë në listepagesat e kompanisë së minimalisht për periudhën Gusht 2022-Tetor 2022.

KVO thekson se për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacion mbi disponimin e drejtuesve teknik të sipërcituar të cilët duhet të figurojnë në licensën e kompanisë.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE, vërehet se operatori ekonomik nuk disponon drejtuesit teknik konkretisht inxhinierin *Hidroteknik, të Mjedisi dhe Topografin*, pasi konstatohet se personat e paraqitur nga OE për përmbushjen e këtij kriteri nuk figurojnë në licensën e kompanisë.

Se dyti, nuk ploteson kriterin 2.3.12 të kriterëve të vecanta të kualifikimit ku parashikohet se:

2.3.12 Operatori ekonomik në rast se nuk është prodhues duhet të paraqesë kontratë furnizimit për materialet si më poshtë:

2.3.12/1 Për Bojrat:

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontratë furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

2.3.12/2 Për Pllakat:

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontratë furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

2.3.12/3 Per materialet e termoizolimit dhe suvase:

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

2.3.12/4 Per materialet hidroizoluese:

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

2.3.12/5 Per materialet elektrike dhe hidraulike:

- Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Komisioni i Vleresimit të Ofertave verën se për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomike duhet të paraqesin për secilin nga materialet e kërkuar: “Kontrate paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar”.

Nga verifikimi në SPE vërehet se bashkëngjitur kontrates së furnizimit, OE ka paraqitur një dokument në gjuhën angleze, të papërkthyer në gjuhën shqipe.

KVO verën se në pikën 2 të nenit 24 të VKM-së 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet se:

2. Në rastin e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, dokumentet e tenderit duhet të hartohen në gjuhët shqip dhe anglisht. Operatorët ekonomikë mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht. Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe. Në këto procedura, në raste specifike, nëse autoriteti/enti kontraktor e gjykon të nevojshme, mund të hartojë dokumentet e tenderit në gjuhët shqip dhe anglisht dhe njofton operatorët ekonomikë se mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik në vendimin nr. 825/2021, mban të njëjtin qëndrim në të cilin theksohet se: “II.4.4. Komisioni i Prokurimit Publik, referuar përcaktimeve ligjore mbi përdorimi e gjuhës shqipe në dokumentet e tenderit, për të qenë sa më të kuptueshme për palët dhe për të krahasuar përputhshmërinë e parametrave dhe të dhënave të mallit që prokurohet, është e nevojshme që për artikujt, objekt-prokurimi, të dhënat e katalogut të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe, gjuhë e përdorur në dokumentet e procedurës së prokurimit. Në këtë kuptim KPP gjykon, se autoriteti kontraktor ka hartuar kriterin në përputhje me dispozitat ligjore dhe kriteri nuk le vend për konfuzion”.

Sa me sipër duke qenë se OE nuk ka paraqitur një autorizim prodhuesi të përkthyer në gjuhën shqipe, ky kriter konsiderohet i papërmbytur.

Sa me sipër Komisioni i Vleresimit të Ofertave mbështetur në nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të

kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e OE “BAMI” SH.P.K, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si përfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “BAMI” SH.P.K, me Nuis J94416206R, *skualifikohet*.

IV- Operatori Ekonomik “NDREGJONI” SH.P.K, me Nuis K31329048I,

Nga verifikimi i dokumentacionit në SPE rezulton se OE:

Se pari, në pikën 1/gj, të kushteve të veqanta parashikohet se: Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë: Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri

KVO verën se, për përmbushjen e këtij kriteri Operatori Ekonomik duhet të paraqesin Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike ku në rastin konkret përfshihet edhe muaji tetor 2022.

Autoriteti Kontraktor vëren se:

1. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se në përmbushje të kriterit sa më sipër operatori ekonomik “NDREGJONI” SH.P.K ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:
- Vërtetim Debie Nr. OSHEE-2022-6544388-EA, date. 02/ 11/ 2022 me anë të së cilës vërtetohet se kërkuesi NDREGJONI SHPK SH.P.K nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratat (me kod), (lista bashkelidhur), titullar/ përdorues i të cilave është NDREGJONI SH.P.K, rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 02.11.2022, pa përfshirë faturën koherente të muajit Tetor 2022.

2. Në nenin 39, “Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike”, pika 7 të, VKM-se 285, date 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht: *Për të provuar se operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon që: a) Operatori ekonomik të ketë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.*

3. Në nenin 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me Vendimin e ERE nr.109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jo familjarë”, përcaktohet shprehimisht që: *“Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.*

4. Autoriteti Kontraktor vlereson se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

